



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV**

Nr. 117/5 prot.

Tiranë më 26.07.2018

VENDIM

Nr. 39, datë 26.07.2018

MBI

ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", neneve 77-112 të Ligjit Nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Ujësjetllës Kanalizime Krujë sh.a.*",

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr. 178 datë 29.06.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 06.07.2018, grupi i inspektimit filloi procesin e hetimit administrativ pranë kontrolluesit "*Ujësjetllës Kanalizime Krujë sh.a.*", me objekt:

- Zbatimi i Ligjit nr. 9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit "*Ujësjetllës Kanalizime Krujë sh.a.*".

Në funksion të Ligjit nr. 9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", "*Ujësjetllës Kanalizime Krujë sh.a.*" është kontrollues i cili mbledh edhe përpunon të dhëna personale të kategorive "*punonjës*" dhe " *klientë*".

Kontrolluesi "*Ujësjetllës Kanalizime Krujë sh.a.*", është person juridik me NIPT J64713209J dhe objekt veprimtarie "*Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve*".

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi sipas planit të kontrollit, në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim më datë 06.07.2018, u konstatua:

1. Kontrolluesi nuk ka "Njoftuar" Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale gjatë ushtrimit të aktivitetit.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 21 pika 1 dhe nenit 22 të Ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar: "Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës...".

Njoftimi është një nga detyrimet më të rëndësishme ligjore i cili në vështrim të nenit 21 të ligjit, duhet të kryhet para se kontrolluesi të kryejë përpunim të dhënash personale për herë të parë. Kontrolluesi është subjekt juridik i cili ka filluar aktivitetin që nga viti 2000 (referuar ekstraktit historik të QKB-së) dhe detyrimi i tij për të njoftuar, ka filluar që me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me përgjegjësi administrative të sanksionueshme sipas nenit 39, pika 1, gërma "d" të Ligjit Nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", me gjobë 10.000 deri në 500.000 lekë.

2. Kontrolluesi nuk ka hartuar rregullore specifike për "Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale". Në rregulloren e institucionit nuk gjenden procedura të shkruara në lidhje me funksionimin e sistemeve, qarkullimin e informacionit, ruajtjen e të dhënave (Backup), vazhdimësinë e biznesit etj.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 27 të ligjit, Vendimit nr. 6/2013 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale" dhe Udhëzimit nr. 21/2012 të Komisionerit "Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha".

Duhet kuptuar drejt nga kontrolluesi rëndësia që ka hartimi dhe përdorimi nga nëpunësit e tij të një rregulloreje të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, si një akt bazë i cili ndërjegjëson dhe sqaron punonjësit për të dhënat personale, rëndësinë e tyre, ruajtjen e fshehtësisë si dhe mënyrën e administrimit të tyre.

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me përgjegjësi administrative të sanksionueshme sipas nenit 39, pika 1, gërma "dh" të Ligjit Nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", me gjobë 10.000 deri në 150.000 lekë.

3. Kontrolluesi nuk ka nënshkruar "Deklaratë Konfidencialiteti" me punëmarrësit të cilët kanë akses në mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale, por në vend të deklaratës kontrolluesi përdor një dokument me titull "Autorizim" ku përmendet në parim ruajtja e konfidencialitetit.

Konstatimi përbën shkelje të nenit 28 të ligjit dhe Vendimit nr. 6/2013 të Komisionerit "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale".

Qëllimi i nënshkrimit të kësaj deklarate është fakti që të gjithë punonjësit të cilët kanë akses në informacione lidhur me të dhënat personale, të tyre apo të klientëve, të kuptojnë qartë dhe drejtë detyrimet që ata kanë për ruajtjen e konfidencialitetit. Në aktin formal me titull "*Deklaratë Konfidencialiteti*", dalë në zbatim të Vendimit nr. 6/2013 të Komisionerit "*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*", merren përsipër të drejta dhe detyrime lidhur me mos transferimin në mënyrë abuzive të të dhënave personale tek personat e paautorizuar. Me nënshkrimin e një akti të tillë, synohet ndërgjegjësimi i plotë i deklaruesit ndaj punëdhënësit për ruajtjen e të dhënave personale, të dhëna që i mëson për shkak të detyrës apo pozicionit që ka, si dhe paralajmërohet marrja e masave të menjëherëshme administrative në rast të shkeljes së këtij standardi.

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me përgjegjësi administrative të sanksionueshme sipas nenit 39, pika 1, gërma "dh" të Ligjit Nr. 9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", me gjobë 10.000 deri në 150.000 lekë.

4. Kontrolluesi disponon një sistem video-survejimi (CCTV) qëllimi i përdorimit të të cilit është garantimi i sigurisë në ambientin e punës. Kontrolluesi nuk informon subjektet e të dhënave "*nëpunës*", "*klientë*" "*vizitorë*" etj., mbi prezencën e këtij sistemi, përpunimin e të dhënave personale imazhe-video, ushtrimin e të drejtës së subjekteve të të dhënave, etj.

Zyra e Komisionerit vëren se, mungesa e informimit të subjekteve të të dhënave lidhur me mbikëqyrjen e ambienteve nëpërmjet sistemit të video-survejimit (CCTV), përbën shkelje administrative të nenit 18, pika 1, të Ligjit: "*Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale*" dhe Udhëzimit Nr.3/2010 të Komisionerit "*Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*".

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me përgjegjësi administrative të sanksionueshme sipas nenit 39, pika 1, gërma "b" të Ligjit Nr. 9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", me gjobë 10.000 deri në 300.000 lekë.

5. Kontrolluesi disponon kontratë shërbimi të ruajtjes së sigurisë fizike, e cila nuk është hartuar në zbatim të nenit 20 të Ligjit.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 20 të ligjit:

"1. Kontrolluesit, për përpunimin e të dhënave personale, mund të punësojnë përpunues, të cilët garantojnë përdorimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Çdo përpunues i të dhënave personale ka këto detyrime:

- a) *të përpunojë të dhënat vetëm në përputhje me udhëzimet e kontrolluesit; të mos i transmetojë ato, përveç kur ka marrë udhëzim nga kontrolluesi;*

- b) të marrë të gjitha masat e sigurisë, sipas këtij ligji dhe të punësojë operatorë, të cilët kanë detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë;
- c) të krijojë, në marrëveshje me kontrolluesin, kushtet e nevojshme teknike dhe organizative për përmbushjen e detyrimeve të kontrolluesit, për të siguruar të drejtat e subjekteve të të dhënave personale;
- ç) t'i dorëzojë kontrolluesit, pas përfundimit të shërbimit të përpunimit, të gjitha rezultatet e përpunimit dhe dokumentacionit, që përmban të dhëna ose t'i mbajë apo t'i shkatërrojë ato me kërkesë të kontrolluesit;
- d) të vërë në dispozicion të kontrolluesit të gjithë informacionin e nevojshëm, për të kontrolluar përputhshmërinë me detyrimet, që rrjedhin sipas shkronjave të mësipërme.

2. Detyrimet e pikës 1 përcaktohen në kontratën e shkruar të kontrolluesit me përpunuesin”.

si dhe Udhëzimit nr. 19/2012 të Komisionerit “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave...”.

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me përgjegjësi administrative të sanksionueshme sipas nenit 39, pika 1, gërma “ç”, të Ligjit Nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, me gjobë 10.000 deri në 300.000 lekë.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, kontrolluesi “Ujësjetllës Kanalizime Krujë sh.a.” është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore pranë ambjenteve të Zyrës së Komisionerit. Kontrolluesi është paraqitur në seancë dhe ka dokumentuar rikuperimin e shkeljeve administrative të konstatuara në kontrollin e ushtruar pranë tij. Ndonëse Zyra e Komisionerit e vlerëson këtë qëndrim dhe reflektim të menjëhershëm, kjo nuk e përjashton kontrolluesin nga përgjegjësia administrative pasi shkeljet e konstatuara, janë kryer para daljes së urdhrin të kontrollit.

Kontrolluesi “Ujësjetllës Kanalizime Krujë sh.a.”, në formën ligjore të aktivitetit të tij tregtar, është person juridik dhe sipas nenit 39/2 të Ligjit Nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, për kundërvajtjet e mësipërme dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se, shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen ngushtë me garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale, saktësinë që të dhënat duhet të kenë dhe kur është e nevojshme, përditësimin e tyre duke ndërmarrë çdo hap të arsyeshëm për të fshirë apo korrigjuar të dhënat e pasakta apo të paplota në lidhje me qëllimin për të cilin ato janë mbledhur apo përpunohen më tej.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 18, 20, 21, 22, 27, 28, 29, 30, 31, 39 pika 1, gërmat “b”, “ç”, “d” dhe “dh”, 39 pika 2, 40 dhe 41 të Ligjit Nr. 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "Ujësjetllës Kanalizime Krujë sh.a.", me gjobë në vlerën 20.000 (njëzetëmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 21 të Ligjit Nr.9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
2. Dënimin e kontrolluesit "Ujësjetllës Kanalizime Krujë sh.a.", me gjobë në vlerën 20.000 (njëzetëmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 18 të Ligjit Nr.9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", në lidhje me informimin e subjekteve të të dhënave mbi prezencën e sistemit të video-surveimit (CCTV).
3. Dënimin e kontrolluesit "Ujësjetllës Kanalizime Krujë sh.a.", me gjobë në vlerën 20.000 (njëzetëmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 27 të Ligjit Nr.9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
4. Dënimin e kontrolluesit "Ujësjetllës Kanalizime Krujë sh.a.", me gjobë në vlerën 20.000 (njëzetëmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 28 të Ligjit Nr.9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
5. Kontrolluesi "Ujësjetllës Kanalizime Krujë sh.a.", në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave personale nga palë të treta, të hartojë kontratat në zbatim të nenit 20 të Ligjit Nr.9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe Udhëzimit Nr. 19/2012 të Komisionerit mbi "Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi. ".
6. Kontrolluesi "Ujësjetllës Kanalizime Krujë sh.a.", të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga ky akt brenda një afati 30 ditor, duke vënë në dijeni Zyrën e Komisionerit për përmbushjen e tyre.
7. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbartimit.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më 26.07.2018.

